



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 05 DHJETOR 2020
“PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E
VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT, DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË
VETQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Referuar nenit 20, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është parashikuar kompetenca e Rregullatorit për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

Gjithashtu kjo dispozitë parashikon se aktet administrative bazë të Rregullatorit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, janë vendimet.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përmban disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 05 dhjetor 2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Ky udhëzim ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 20, pikat 1, shkronja “a”, dhe 3, nenit 46, pikat 1 dhe 2, nenit 50, pika 3, nenit 52, nenit 62, nenit 93, nenit 108, pika 7, dhe nenit 109, pika 1, të Kodit Zgjedhor, si dhe në referim të vendimit nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”.

Në fazën përgatitore për zhvillimin e zgjedhjeve të datës 14 Maj 2023, Komisioneri ka marrë të gjitha masat për të monitoruar zbatimin e detyrimeve të bashkive për evidentimin e qendrave të votimit ku ka të regjistruar persona me aftësi të kufizuar. Referuar komunikimit me bashkitë rezulton se në përafërsisht 2820 QV janë evidentuar votues me aftësi të kufizuar. Nga këto QV, 190 qendra votimi janë në kate të dyta dhe 12 në kate të treta.

Përafërsisht 1710 QV janë në kate të para, nga të cilat 572 QV nuk janë të pajisura me rampa. Pjesa tjetër e qendrave të votimit janë me akses të drejtpërdrejtë.

Për 572 QV të cilat nuk janë të pajisura me rampa, bashkitë kanë informuar KQZ se do të vënë në dispozicion të votuesve me aftësi të kufizuar staf për asistimin e tyre.



Në lidhje me qendrat e votimit të cilat janë të vendosura në katet e dyta dhe të treta, Komisioneri u ka kërkuar bashkive që t'i transferojnë ato në kate të para. Të gjitha bashkitë që kanë këtë problematikë po marrin masat për të bërë transferimin e qendrave të votimit në katet e para dhe ky proces po ndiqet në dinamikë.

Sjellim në vëmendje se standardet teknike për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar janë të përcaktuar në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuptim, çdo ambient që ofron shërbim publik, projektohet e ndërtohet në zbatim të këtyre rregullave teknike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka patur parasysh pikërisht këtë rregullim ligjor kur ka miratuar udhëzimin në vitin 2020.

Udhëzimi në fuqi në nenin 5, pika 3/b, ngarkon me përgjegjësi kryetarin e NJQV-së për marrjen e masave për krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuar.

Pas zgjedhjeve të 25 Prillit 2021 dhe zbatimit të udhëzimit nr. 1/2020, u konstatua se detyrimi i parashikuar për kryetarët e NJQV ka nevojë për një adresim më të plotë për të lehtësuar aksesimin e personave me aftësi të kufizuar në qendrat e votimit.

Propozohet ndryshim i udhëzimit duke përcaktuar së paku një standard dysHEME për kriteret e qendrave të votimit.

Konkretisht, propozohet që shkronja “b”, e pikës 3, të nenit 5 të udhëzimit të ndryshohet duke referuar në standardet kombëtare të çështje të zbatimit të rregullave teknike sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar me qëllim aksesimin e tyre në qendrën e votimit, dhe minimalisht të sigurohet që:

- Hyrja për në qendrën e votimit të ketë kalim të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme,
- Dyert e hyrjes për në çdo qendër votimi (hyrja kryesore dhe hyrja brenda QV-së) të lejojnë kalimin me lehtësi edhe nga personat në karrige me rrota. Pragu i derës përpara dhe pas saj të jetë në të njëjtin rrafsh me sipërfaqet e ambienteve.

Udhëzimi parashikon detyrimin për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për të caktuar në katin e parë të ndërtesave, qendrat e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu, në projektaktin e propozuar është parashikuar edhe mekanizmi i kontrollit për zbatimin e standardeve minimale të kërkuara, duke përcaktuar detyrimin e kryetarëve të NJQV për t'i dhënë informacion KQZ sa herë që i kërkohet.

Këto ndryshime, adresojnë gjithashtu rekomandimet e OSBE ODIHR, rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Projektvendimi u është dërguar për mendim disa organizatave të shoqërisë civile të angazhuara me proceset zgjedhore dhe Fondacionit “Së bashku”.

Fondacioni “Së Bashku”, ka përcjellë disa rekomandime, si vijon:

Së pari, ata kërkojnë që aksesueshmëria të jetë e pranishme në të gjitha qendrat e votimit pasi ajo mund t'u shërbejë jo vetëm personave me aftësi të kufizuara dhe personave me dëmtime të përkohshme por edhe të moshuarve apo personave që janë dhe jashtë skemës së përfitimit të pagesave si pasojë e një paaftësie.



- *Sqarojmë se pikërisht, duke pasur parasysh sa kërkohet, jemi kujdesur që të referohet në standardet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të miratuara me VKM nr. 1503, datë 19.11.2008. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vlerësuar se e drejta e votës është një e drejtë kushtetuese, ka vendosur në këtë projektvendim kriterin minimal që qendrat e votimit të jenë në katet e para dhe të lejojnë pa pengesë hyrjen për personat me aftësi të kufizuar jo vetëm brenda qendrës së votimit, por edhe në hyrjen që të drejton për në qendrën e votimit.*

Së dyti, mënyra e vendosjes së mobiljeve dhe vetë mobiljet, përfshirë dhomat e votimit, duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

- *KQZ pajis qendrat e votimit me dhoma të fshehta votimi të posaçme për personat me aftësi të kufizuar.*

Së treti, aksesueshmëria duhet të jetë e pranishme në të gjitha qendrat e votimit dhe mundësia për të votuar në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara në shikim duhet të jetë e disponueshme në çdo qendër votimi, pavarësisht nëse ka persona me aftësi të kufizuara në shikim të regjistruar apo jo

- *Për sa i përket paaftësisë së kufizuar në shikim, sjellim në vëmendje se KQZ pajis çdo qendër votimi me maskën për votuesit e verbër (me alfabetin BRAILLE).*

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 05 dhjetor 2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes 3 vjet
Punoi:
E.Meta _____
M.Koja _____
M.Çelmeta _____
A. Lamçe _____
Y.Merkaj _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .1.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 5.12.2020, "PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT, DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET"

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "a", dhe 3, nenit 46, pikat 1 dhe 2, nenit 50, pika 3, nenit 52, nenit 62, nenit 93, nenit 108, pika 7, dhe nenit 109, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 01.12.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Shkronja "b", e pikës 3, e nenit 5 ndryshohet si më poshtë vijon:
 - "b) zbatimin e rregullave teknike sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara me qëllim aksesimin e tyre në qendrën e votimit duke siguruar së paku që:
 - i. Hyrja për në qendrën e votimit të ketë kalim të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme,
 - ii. Dyert e hyrjes për në çdo qendër votimi (hyrja kryesore dhe hyrja brenda QV-së) të lejojnë kalimin me lehtësi edhe nga personat në karrige me rrota. Pragu i derës përpara dhe pas saj të jetë në të njëjtin rrafsh me sipërfaqet e ambienteve."

Data: 1.2023 Nr:
Ora:



"Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020"

- b) Pas pikës 3, të nenit 5, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:
“4. Në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij neni, me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bashkitë dërgojnë informacionin për masat e marra, brenda 10 ditëve nga marrja e saj.”.
- c) Në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 8, fjalët “...si rregull...” hiqen.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**